



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 19, datë 27.01.2020

**PËR SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE PER PROKURORE NE  
PROKURORINE E POSAÇME KUNDER KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TE  
ORGANIZUAR**

Në përputhje me nenin 6 dhe nenin 7 të Ligjit nr. 95/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*", nenit 159 të ligjit nr. 115/2016 "*Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë*", i ndryshuar si dhe ligjit 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Rregulloren "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar", miratuar me vendim nr. 51, datë 19.03.2019 nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 2 (dy) vendeve vakante për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) përmes procedurës së ngritjes në detyrë.
2. Njoftimi i vendeve vakante si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të publikohen në faqen zyrtare të institucionit.

3. Shprehja e interesit duhet të dorëzohet jo më vonë se 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditë kalendarike nga shpallja e thirrjes në faqen zyrtare të institucionit dhe të dorëzohet në adresën:

*Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Qemal Stafa" Nr. I, godina e Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë.*

Mbi zarf duhet të shënohet: "Shprehje Interesi për prokuror për në SPAK".

Gjithashtu mund të dorëzohet dhe në formë elektronike në adresën: [vendevakante@klp.al](mailto:vendevakante@klp.al) (në këtë rast të gjitha dokumentat duhet të jenë të skanuara bashkelidhur kërkesës për aplikim).

Shprehja e Interesit duhet të përmbajë shpjegimet e kandidatit për arsyet e kandidimit (*letra e motivimit jo më shumë se 3 faqe A4*).

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të Këshillit..

**KRYETARI**

**GJENT IBRAHIMI**

